

UDHEZIM 14,

datë 3.5.2017

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.33/2017 “PËR PAGESËN DHE FSHIRJEN/ SHUARJEN E DETYRIMEVE TATIMORE, DETYRIMEVE TË PAGUESHME NË DOGANË, SI DHE PROCEDURËN E HEQJES NGA QARKULLIMI TË MJETEVE TË TRANSPORTIT PAS FSHIRJES/ SHUARJES SË DETYRIMEVE TATIMORE”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 15 të ligjit nr. 33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen e pjesshme të detyrimeve tatimore, doganore, si dhe procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes së detyrimeve tatimore”,
Ministri i Financave

UDHËZON:

1.OBJEKTI I UDHËZIMIT

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurën e zbatimit të ligjit nr.33/2017 datë “Për pagesën dhe fshirjen e pjesshme të detyrimeve tatimore, doganore, si dhe procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes së detyrimeve tatimore”, më poshtë referuar si “ligji”.

II. SUBJEKTET PËRFITUESE

Në zbatim të nenit 3, të ligjit, subjektet që do të përfitojnë të drejtën për pagesën dhe fshirjen e pjesshme të detyrimeve tatimore, janë si më poshtë:

- a) Subjektet e regjistruar në regjistrin aktiv, pasiv ose të çregjistruar, për detyrime tatimore ndaj administratës tatimore qendrore dhe vendore, sipas nenit 5, 6, 7 dhe 11 të ligjit;
- b) Subjektet debitorë ndaj administratës doganore për detyrime sipas neneve 9, 10 dhe 11 të ligjit;
- c) Subjektet pronarë të mjeteve të transportit, siç përcaktohet në nenin 12 të ligjit.

III. SUBJEKTET QË NUK PËRFITOJNË

- 1. Në zbatim të nenit 4 të ligjit, nga fshirja/shuarja e detyrimeve nuk përfitojnë subjektet që kanë detyrime tatimore/doganore, të cilët janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën tatimore dhe/ose doganore, në kuptim të legjislacionit të fushës.
- 2. Organi tatimor qendror apo vendor dhe organi doganor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij udhëzimi, duhet të përgatisë listën e tatimpaguesve që nuk përfitojnë nga fshirja/shuarja e detyrimeve. Kjo listë përditësohet çdo muaj.
- 3. Listat e detajuara dhe të përditësuara do të shërbejnë për njoftim zyrtar të tatimpaguesve që përjashtohen nga zbatimi i ligjit.
- 4. Njoftimi zyrtar i tatimpaguesve të cilët përjashtohen nga zbatimi i ligjit, do të bëhet në faqen zyrtare të organit tatimor qendror/ vendor/doganor brenda 45 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij udhëzimi. Ky njoftim përditësohet çdo muaj sipas vendimeve të gjyqësore të formës së prerë për veprat penale në fushën tatimore dhe/ose doganore të marra pas këtij afati.

IV. FSHIRJA E DETYRIMEVE TATIMORE

1. Fshihen/shuhen automatikisht detyrimet tatimore të papaguara sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 2 të ligjit, që i përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë, dhe që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e subjektit, përveç kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Këtu përfshihet çdo detyrim tatimor i regjistruar në sistemin informatik ose jashtë sistemit, por që është i regjistruar në kontabilitetin e drejtorive rajonale tatimore.

1.1 Fshihen/shuhen detyrimet e akcizës të administruara nga ana e organit tatimor që i përkasin periudhave deri në 31 dhjetor 2010.

2. Fshihen/shuhen detyrimet e papaguara të përcaktuara sipas ligjit nr. 9632/2006 “Për taksat vendore” i ndryshuar, që u përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë sipas regjistrimeve të pushtetit vendor.

3. Fshihen/shuhen automatikisht dënimet administrative (gjobat) dhe kamatëvonesat për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, që i përkasin periudhave tatimore dhjetor 2010 e më parë, që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e subjektit.

4. Për rastet kur data e njoftim vlerësimit apo akt konstatimit mban datën 31.12.2010 dhe më parë, ndërsa data e kontabilizimit është bërë pas kësaj date, fshirja/shuarja bëhet manualisht nga strukturat përkatëse.

V. FSHIRJA/SHUARJA PJESORE E DETYRIMEVE TATIMORE ME KUSHT PAGIMIN E TATIMIT/TAKSËS/TARIFËS /KONTRIBUTIT

1. Fshihen/shuhen gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të regjistruara në llogarinë e subjektit, me kushtin që deri më 31.12.2017, të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi, për:

a) detyrimet tatimore, që i përkasin periudhave tatimore janar 2011 deri dhjetor 2014, duke u aplikuar sipas llojit të tatimit;

b) kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që i përkasin periudhave tatimore janar 2011 deri dhjetor 2014;

c) taksat/tarifat vendore të papaguara, që u përkasin periudhave tatimore janar 2011 deri dhjetor 2014;

2. Ky përcaktim zbatohet edhe në rastin kur tatimi/taksa/tarifa/kontributi është paguar përpara hyrjes në fuqi të ligjit. Nëse subjekti për një periudhë të caktuar nuk ka tatim për të paguar për periudhat tatimore sipas llojit të tatimit që i përkasin periudhave janar 2011 deri në dhjetor 2014, duke qenë se e ka paguar më parë ose tatimi ka qenë zero, atëherë atij i aplikohet fshirja/shuarja e kamatëvonesave dhe gjobave sipas përcaktimeve në nenin 6 të ligjit dhe kësaj pike të udhëzimit.

3. Për rastet kur data e njoftim vlerësimit apo akt konstatimi mban datën 31.12.2014 dhe më parë, ndërsa data e kontabilizimit është bërë pas kësaj date, fshirja/shuarja bëhet manualisht nga strukturat përkatëse.

4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të dërgojë zyrtarisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave detyrimet e tatimpaguesve për akcizë/gjobë/ kamatëvonesë e dënim administrativ për periudhën tatimore janar 2011 deri dhjetor 2014 sipas periudhave që i përkasin. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për këtë tatim do të zbatojë

procedurën e fshirjes/shuarjes pjesore të detyrimeve të akcizës, në zbatim të dispozitave të nenit 6 të ligjit.

VI. FSHIRJA/SHUARJA E DETYRIMEVE TATIMORE TË TJERA

Janë gjithashtu objekt i fshirjes/shuarjes sipas ligjit, detyrimet tatimore të mëposhtme, pavarësisht periudhës tatimore që i përkasin:

1. Fshihen/shuhet automatikisht detyrimet tatimore përfshirë tatimin/kontributin / taksën/ tarifën, kamatëvonesën dhe dënimet administrative për subjektet persona fizikë ose juridike, të cilët rezultojnë të çregjistruar në QKB, me vendim gjykate, ose që janë të çregjistruar në administratën tatimore deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit.

1.1 Organi tatimor qendror/vendor përgatit listën e subjekteve sipas përcaktimeve të mësipërme, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të udhëzimit.

1.2 Tatimpaguesit përfitues të ligjit sipas listës së përgatitur, pas kryerjes së fshirjes së detyrimeve nga sistemi, në mënyrë automatike do të çregjistrohen nga sistemi me datën efektive të çregjistrimit sipas listës pa qenë e nevojshme dorëzimi i deklaratave dhe listëpagesave të padorëzuara.

1.3 Për detyrimet vendore, organet e pushtetit vendor marrin masat për fshirjen e detyrimeve nga regjistrat përkatës.

1.4 Tatimpaguesit të cilët rezultojnë të çregjistruar në QKB, me vendim gjykate, ose që janë të çregjistruar në administratën tatimore deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk kanë detyrime tatimore të papaguara, në mënyrë automatike do të çregjistrohen nga sistemi me datën efektive të çregjistrimit sipas listës pa qenë e nevojshme dorëzimi i deklaratave dhe listëpagesave të padorëzuara.

2. Në zbatim të nenit 7 të ligjit, fshihen/ shuhet në mënyrë automatike dënimet administrative (gjobat) tatimore të llogaritura automatikisht nga sistemi për deklarim të vonuar sipas nenit 113 të ligjit nr. 9920, datë 19.08.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, deri më 31.12.2016, përfshirë edhe dënimet që lidhen me afatin e deklarimit të të punësuarve pavarësisht periudhës tatimore që i përkasin.

3. Fshihen/shuhet automatikisht dënimet administrative (gjobat) për dorëzim të vonuar të vendimit për destinimin e rezultatit dhe dorëzim me vonë të pasqyrave financiare të aplikuara sipas ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, të llogaritura deri në datën 31.12.2016 pavarësisht periudhës tatimore që i përkasin.

4. Fshihen/shuhet automatikisht dënimet administrative (gjobat) për mosdeklarim në afat, për deklarata të padorëzuara, me kusht që çdo deklaratë e padorëzuar të dorëzohet deri në datën 30.06.2017 pavarësisht periudhës tatimore që i përkasin.

5. Fshihen/shuhet automatikisht dënimet administrative (gjobat) për shoqëritë e autorizuara, të parashikuara në nenin 123 të ligjit nr. 9920, datë 19.08.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të evidentuara në llogarinë e subjektit nëpërmjet akt konstatimit deri më datën 31.12.2016 pavarësisht periudhës tatimore që i përkasin.

6. Fshihen/shuhet automatikisht dënimet administrative (gjobat) si rezultat i aplikimit të dispozitave të ligjit nr.99/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese pavarësisht periudhës tatimore që i përkasin.

7. Përveç sa parashikohet në nenin 5, fshihen/shuhen detyrimet tatimore të papaguara sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 2 të këtij ligji, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe të detyrimeve të vetëdeklaruar dhe të papaguara, të shoqërive që operojnë në sektorin elektro-energjitik dhe janë 100 % me kapital shtetëror, që i përkasin periudhave tatimore nga 1.1.2011 deri 31.12.2013.

Gjobat dhe kamatëvonesat për kontributet e sigurimeve dhe detyrimet e vetëdeklaruar për këto periudha, fshihen/shuhen, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi.

7.1 Për detyrimet e këtyre shoqërive për periudhën janar deri dhjetor 2014, fshihen/shuhen gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kushtin që brenda datës 31.12.2017, të paguhet i plotë tatimi/taksa/ tarifa/kontributi.

7.2 Në zbatim të referimeve të mësipërme, ngarkohet organi tatimor të evidentojë dhe të përcaktojë subjektet e këtij sektori që përmbushin kushtet. Nga ana e tij duhet të përcaktohet qartë detyrimi tatimor që do të fshihet sipas përcaktimeve ligjore.

Për pagesën e detyrimeve të këtij sektori, përcaktohet një plan pagesash periodik i cili shtrihet nga hyrja në fuqi e ligjit deri në dhjetor 2017, për pagimin e tatimit/taksës/kontributit brenda datës 31.12.2017.

7.3 Informacioni i detajuar me subjektet e këtij sektori dhe detyrimet që do të fshihen/shuhen, do të përgatitet nga ana e drejtorive rajonale tatimore përkatëse dhe do të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

8. Përveç sa parashikohet në nenin 5, fshihen/shuhen detyrimet tatimore të papaguara sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 2 të këtij ligji, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të shoqërive që operojnë në sektorin ujësjellëskanalizime dhe janë 100 % me kapital shtetëror, që i përkasin periudhave tatimore nga 1.1.2011 deri 31.12.2013. Gjobat dhe kamatëvonesat për kontributet e sigurimeve për këto periudha fshihen/shuhen, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë kontributi.

8.1 Për detyrimet e këtyre shoqërive për periudhën janar deri dhjetor 2014, fshihen/ shuhen gjobat dhe kamatëvonesat që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që brenda datës 31.12.2017 të paguhet i plotë tatimi/taksa/tarifa/kontributi.

8.2 Në zbatim të referimeve të mësipërme, ngarkohet organi tatimor të evidentojë dhe të përcaktojë subjektet e këtij sektori që përmbushin kushtet. Nga ana e tij duhet të përcaktohet qartë detyrimi tatimor që do të fshihet sipas përcaktimeve.

8.3 Informacioni i detajuar me subjektet e këtij sektori dhe detyrimet që do të fshihen/ shuhen, do të përgatitet nga ana e drejtorive rajonale Tatimore përkatëse dhe do të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

9. Shuhen efektet tatimore për detyrime të papaguara të regjistruara ose jo, apo në proces kontrolli, si pasojë e lëshimit jo brenda së njëjtës periudhë tatimore të kryerjes së furnizimit, të dokumentit që vërteton përjashtimin nga TVSH, ose si pasojë e moslëshimit të këtij vërtetimi, me kusht që në çdo rast aplikimi pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore të jetë paraqitur deri më 31.12.2014.

Sipas kësaj dispozite përfitojnë ato raste të cilat është aplikuar në AKBN brenda datës 31.12.2014 dhe AKBN nuk ka lëshuar asnjë dokument/ vërtetim për rastin. Për çdo rast për të cilin ka një

dokument/ vërtetim të lëshuar nga AKBN i cili nuk ka miratuar përjashtimin nga TVSH, rasti nuk është objekt i dispozitave të pikës “f” të nenit 7 të ligjit.

9.1 Për çdo subjekt që është në proces kontrolli mbahet një proces verbal i veçantë për këtë qëllim, në të cilin në mënyrë analitike listohen rastet si dhe data e aplikimit në AKBN, ka ose jo vërtetim nga AKBN, është miratuar ose jo/ është shprehur AKBN/ose jo, data e miratimit/ refuzimit nëse ka. Për këta tatimpagues që janë në proces kontrolli ende të papërfunduar, DRT respektive të marrin masat për të përfunduar kontrollet tatimore, duke marrë në konsideratë parashikimet e ligjit.

9.2 Nga ana e organit tatimor, evidentohen tatimpaguesit sipas përcaktimeve të mësipërme për vlerën e detyrimit, llojin e detyrimit, periudhën dhe kushtin e plotësuar.

9.3 Informacioni i detajuar me subjektet që përmbushin kushtin e mësipërm dhe detyrimet që do të fshihen/shuhet, do të përgatitet nga ana e drejtorive rajonale tatimore përkatëse dhe do të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

10. Fshihen/shuhet gjobat dhe kamatëvonesat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të vetëpunësuarit në bujqësi, që i përkasin periudhave nga 1 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2016, me kusht që pagesa e kontributeve të kryhet brenda datës 31.12.2017. 11. Për rastet kur sipas pikave 1-10 të këtij kreu, data e akt konstatimit mban datën 31.12.2016 dhe më parë, ndërsa data e kontabilizimit është bërë pas kësaj date, fshirja/shuarja bëhet manualisht nga strukturat përkatëse.

VII. KOMPENSIMI I DETYRIMEVE DEBITORE ME GJENDJEN KREDITORE DHE TEPRICËN KREDITORE TË TVSH-SË

1. Subjektet që kanë tepricë kreditore të TVSH-së ose të një tatimi tjetër përfitojnë nga fshirja e detyrimeve tatimore sipas neneve 5, 6, 7 dhe 11 të këtij ligji, pas kompensimit (zvogëlimit) të tepricës deri në masën e tatimit të papaguar pa përfshirë gjobat dhe kamatëvonesat si dhe detyrimet tatimore të pahedhura në sistem që i përkasin periudhave tatimore deri më 31.12.2010.

2. Në rastet kur sipas nenit 6, teprica nuk mbulon vlerën e plotë të tatimit të papaguar atëherë duhet të kryhet pagesa për pjesën e mbetur dhe më pas bëhet fshirja e kamatëvonesave dhe e dënimeve administrative.

3. Përcaktimet e këtij neni për kompensimin zbatohen automatikisht pa kontroll, përveç rasteve të parashikuara në pikën 1 të nenit 11 të këtij ligji, për të cilat ky nen zbatohet kur subjekti heq dorë nga ankimi administrativ ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit pranë gjykatës kompetente.

4. Sipas këtij neni, kompensimit nuk i nënshtrohen detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

5. Kompensimi i tepricës kreditore të TVSHsë dhe çdo lloj tatimi duhet të përdoret për të përputhur fillimisht detyrimet brenda llojit të vetë të tatimit dhe me pas tek tatimet e tjera. Nga ky kompensim përjashtohen detyrimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

VIII. FSHIRJA E DETYRIMEVE TË PAGUESHME NË DOGANË

Në zbatim të neneve 9, 10, dhe 11 të ligjit nr.33/2017 të sipërcituar, degët doganore kryejnë evidentimin e plotë të të gjithë debitorëve ndaj administratës doganore bazuar në përcaktimet e ligjit

duke marrë në konsideratë datën e vendimit, llojin e mallit, listën e makinerive dhe pajisjeve të përjashtuara nga pagesa e tatimit mbi vlerën e shtuar që ishte në fuqi deri më 31.12.2016. Për këtë qëllim degët doganore hartojnë edhe listat respektive të debitorëve sipas procedurave të mëposhtme të përcaktuar në këtë udhëzim. Për të administruar gjithë procedurën e fshirjes sipas këtij ligji, kryetari i degës doganore ngre një komision në përbërjen e të cilit janë kryetari i degës doganore, juristi i degës doganore, specialisti i borxhit dhe specialisti i financës. Kryetari i degës mund të caktojë në përbërje të këtij komisioni edhe punonjës të tjerë të degës doganore.

IX. PROCEDURA QË DUHET NDJEKUR NGA DEGA DOGANORE NË ZBATIM TË NENIT 9 TË LIGJIT

1. Në zbatim të pikës 1, të nenit 9, të ligjit, dega doganore harton listën e plotë të të gjithë debitorëve, për të cilët detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2 të nenit 2 të ligjit, janë të papaguara dhe të evidentuara nëpërmjet vendimeve administrative deri më 31 dhjetor 2010.

Kjo listë do të përmbajë në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat në lidhje me: emrin e kompanisë/individit, NIPT-in/ID, numrin dhe datën e vendimit administrativ, detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të këtij ligji, shumën e paguar nëse ka, shumën që fshihet/shuhet.

Kjo listë e plotë do të konsiderohet si lista finale mbi të cilën do të vazhdojë procedura e administrimit të fshirjes nga Komisioni.

Komisioni pasi verifikon saktësinë e listës, përmes një procesverbali të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit miraton menjëherë fshirjen e këtyre detyrimeve. Lista e miratuar i kalon për fshirje zyrës së financës dhe zyrës së borxhit në degën doganore.

Lista e debitorëve përfitues, pasi u janë fshirë detyrimet e pagueshme në doganë sipas pikës 1, të nenit 9, të ligjit, i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Debitorët të cilët kanë kryer pagesë të pjesshme të detyrimeve të pagueshme në doganë në zbatim të vendimeve administrative të specifikuara sipas pikës 1 të nenit 9 të ligjit, përfitojnë nga fshirja vetëm për pjesën e papaguar të detyrimeve të pagueshme.

2. Në zbatim të pikës 2, të nenit 9, të ligjit, dega doganore harton listën e plotë të të gjithë individëve debitorë lidhur me produktet e duhanit, për të cilët detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2 të nenit 2 të ligjit, janë të papaguara dhe të evidentuara nëpërmjet vendimeve administrative deri më 31 dhjetor 2016.

Kjo listë do të përmbajë në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat në lidhje me: emrin individit, ID nëse disponohet, numrin dhe datën e vendimit administrativ, detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të këtij ligji, shumën e paguar nëse ka, shumën që fshihet. Kjo listë e plotë do të konsiderohet si lista përfundimtare mbi të cilën do të vazhdojë procedura e administrimit të fshirjes nga Komisioni.

Komisioni pasi verifikon saktësinë e listës, përmes një procesverbali të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit, miraton fshirjen e këtyre detyrimeve. Lista e miratuar i kalon për fshirje zyrës së financës dhe zyrës së borxhit në degën doganore.

Lista e debitorëve përfitues, pasi u janë fshirë detyrimet e pagueshme në doganë sipas pikës 2, të nenit 9, të ligjit, i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Debitorët të cilët kanë kryer pagese të pjesshme të detyrimeve të pagueshme në doganë në zbatim të vendimeve administrative të specifikuara sipas pikës 2 të nenit 9 të ligjit, përfitojnë nga fshirja vetëm për pjesën e papaguar të detyrimeve të pagueshme.

3. Në zbatim të pikës 3, të nenit 9, të ligjit, dega doganore brenda 60 ditëve kalendrike nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi harton listën e plotë të të gjithë debitorëve të cilat janë të evidentuara nga administrata doganore deri në përfundim të afatit të zbatimit të ligjit, për TVSH-në e shtyrë dhe të papaguar për makineritë e pajisjet, importimi i të cilave është përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar, sipas listës përkatëse në fuqi, deri në datë 31.12.2016.

Kjo listë do të përmbajë në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat në lidhje me: emrin e kompanisë/individit, NIPT-in/ID, shumën e detyrimeve të pagueshme, kodin tarifor sipas NKM për makineritë dhe pajisjet, detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të këtij ligji, shumën e paguar nëse ka, shumën që fshihet/shuhet.

Lista e plotë e përgatitur nga dega doganore do të konsiderohet si lista përfundimtare mbi të cilën do të vazhdojë procedura e administrimit të fshirjes/shuarjes nga komisioni;

Komisioni pasi verifikon saktësinë e listës, përmes një procesverballi të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit, miraton fshirjen/ shuarjen e këtyre detyrimeve. Lista e miratuar i kalon për fshirje zyrës së financës dhe zyrës së borxhit në degën doganore.

Lista e debitorëve përfitues, pasi u janë fshirë/shuar detyrimet e pagueshme në doganë sipas pikës 3, të nenit 9, të ligjit, i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Debitorët të cilët kanë kryer pagese të pjesshme të detyrimeve të pagueshme në doganë në zbatim të vendimeve administrative të specifikuara sipas pikës 3 të nenit 9 të ligjit, përfitojnë nga fshirja vetëm për pjesën e papaguar të detyrimeve të pagueshme.

X. PAGESA E DETYRIMIT DHE FSHIRJA ME KUSHT E DETYRIMEVE TË PAGUESHME NË DOGANË NË ZBATIM TË NENIT 10 TË LIGJIT

1. Në zbatim të pikës 1, të nenit 10, të ligjit, dega doganore brenda 15 ditëve kalendrike nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, harton listën e plotë të të gjithë debitorëve për të cilët detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të ligjit, janë të papaguara dhe të evidentuara sipas vendimeve administrative nga 1 janari 2011 deri 31 dhjetor 2014.

Kjo listë do të konsiderohet si lista bazë në të cilën:

a) Do të pasqyrohen debitorët sipas pikës 1, të cilët nuk kanë kryer asnjë pagesë dhe vendimi administrativ ka të përcaktuara detyrime të pagueshme sipas pikës 2 të nenit 2, të ligjit.

b) Do të pasqyrohen debitorët të cilët kanë përmbushur pjesërisht kushtin e pagesës (debitori ka kryer pagesë të pjesshme të detyrimit të pagueshëm në doganë pa përfshirë gjokat, kamatëvonesat dhe interesat kompensuese), deri në momentin e hartimit të kësaj liste.

c) Do të pasqyrohen debitorët të cilët e kanë përmbushur plotësisht kushtin e pagesës (pagesa e plotë e detyrimit të pagueshëm në doganë pa përfshirë gjokat, kamatëvonesat dhe interesat kompensuese).

d) Do të pasqyrohen debitorët të cilët janë shpallur të tillë sipas vendimit administrativ të degës doganore vetëm për gjobë dhe/ose kamatëvonesa dhe/ose interesa kompensuese.

Lista e debitorëve sipas pikës 1 do të përmbajë në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat në lidhje me: emrin e kompanisë/individit, NIPT-in/ID, numrin dhe datën vendimit administrativ, detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të këtij ligji, shumën e paguar nëse ka, shumën që duhet paguar për të plotësuar kushtin e fshirjes, shumën që fshihet.

1.1 Për debitorët e përfshirë në listë sipas germës “a” dhe “b” të pikës 1, zbatohet procedura si më poshtë vijon:

Për të gjithë këta debitorë, nëse nuk është kryer procedura e njoftimit, dega doganore bën menjëherë njoftimin e debitorit në të cilin sqaron gjithashtu, edhe kushtin për pagesën e pjesës së plotë të detyrimit të pagueshëm në doganë pa përfshirë gjokat, kamatë vonesat dhe interesat kompensuese.

Të gjithë debitorët përfitues, duhet që brenda datës 31.12.2017 të paraqesin zyrtarisht pranë degës doganore ku figurojnë debitorë, kopjen e mandat pagesës që përfaqëson pagesën sipas kushtit.

Mandati i pagesës së kryer nga debitori dhe kopja e deklaratës së amenduar i bashkëlidhen listës bazë për verifikim nga Komisioni. Gjithashtu kopje e mandatit të pagesës së kryer nga debitori dhe kopje e deklaratës së amenduar bëhen pjesë e dosjes përkatëse të debitorit.

Komisioni çdo fillim muaji analizon dhe verifikon listën e këtyre debitorëve dhe dokumentet bashkëlidhur, harton një procesverbal të detajuar në të cilin përcakton rastet që përfitojnë dhe ato që nuk përfitojnë, duke dhënë edhe sqarimet përkatëse. Ky procesverbal nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

Debitorët të cilët kanë paguar një pjesë të detyrimit të pagueshëm në doganë e specifikuar në germën “b” të pikës 1, përfitojnë nga falja vetëm për pjesën e mbetur të detyrimit të pagueshëm në doganë të përbërë nga gjoka, kamatëvonesa dhe interesa kompensuese nëse është plotësuar kushti i pagesës bazuar në dispozitat e ligjit.

Në rast të mosplotësimit të kushtit (pagesës jo të plotë të 100% të detyrimit të pagueshëm në doganë, pa përfshirë gjokat, kamatë vonesat dhe interesat kompensuese), Komisioni nuk miraton fshirjen e detyrimeve të pagueshme në doganë dhe për këtë vendimmarrje njofton debitorin.

Për debitorët të cilët kanë plotësuar kushtin e pagesës, komisioni miraton fshirjen. Lista e miratuar i kalon për fshirje zyrës së financës dhe zyrës së borxhit në degën doganore.

Lista e debitorëve përfitues sipas kësaj pike, pasi u janë fshirë detyrimet e pagueshme në doganë si më lart, i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

1.2 Për debitorët që përshihen në germat “c” dhe “d” të pikës 1, Komisioni verifikon saktësinë e listës.

Lista për çdo debitor të germës “c” që ka përmbushur kushtin e pagesës duhet të ketë bashkëngjitur kopjen e deklaratës së amenduar.

Komisioni pas verifikimit mban një procesverbal të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe miraton menjëherë fshirjen e detyrimeve të pagueshme në doganë. Për debitorët e përfshirë në germën “d”, të pikës 1 Komisioni miraton menjëherë fshirjen e gjokave, kamatëvonesave dhe/ose interesave kompensuese.

Lista e miratuar i kalon për fshirje zyrës së financës dhe zyrës së borxhit në degën doganore. Lista e debitorëve të cilët kanë përfituar nga falja dhe fshirja e detyrimeve të pagueshme sipas kësaj pike, i dërgohet edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

2. Në zbatim të pikës 2, të nenit 10, të ligjit, dega doganore brenda 15 ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, harton listën e plotë të debitorëve të evidentuara nëpërmjet vendimeve administrative nga 1 janar 2011 deri në 31 dhjetor 2016, dhe që janë shpallur debitorë vetëm për shkelje të regjimit të lejitimit të përkohshëm, për të cilët detyrimet e pagueshme në doganë sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të ligjit, janë të papaguara.

Dega doganore, për debitorët e përfshirë në listën e pikës 2 do të zbatojë të njëjtën procedurë të përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu.

XI. DETYRIMET TATIMORE DHE DOGANORE QË JANË NË PROCES ANKIMIMI NË ZBATIM TË NENIT 11 TË LIGJIT

1. Subjekti i cili është në proces ankimimi administrativ ose gjyqësor për detyrimet tatimore/detyrimet e pagueshme në doganë, i nënshtrohet këtij ligji nëse ai heq dorë nga ankimi administrativ ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit pranë gjykatës administrative kompetente.

1.1 Të gjithë tatimpaguesit për gjobat e parashikuara në nenin 7 të ligjit, pikat b, c, ç, d, dh, përfitojnë nga zbatimi i ligjit të fshirjes, pavarësisht nëse janë në proces ankimimi.

1.2 Për këtë qëllim, lista e subjekteve të cilat janë në proces gjyqësor për vlerën dhe periudhën e detyrimit të ankimuar, do të përcaktohen nga ana e organit tatimor/doganor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e udhëzimit. Lista e subjekteve të cilat janë në proces gjyqësor, do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të administratës tatimore/doganore.

1.3 Në momentin kur subjekti paraqet pranë organit tatimor/doganor aktin e heqjes dorë nga ankimi administrativ ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit, bëhet pjesë e shqyrtimit të ligjit të faljes.

2. Çdo drejtori rajonale tatimore, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të rishikojë të gjitha marrëveshjet e pagesës me këste të detyrimit të papaguar, me qëllim përfshirjen e këtyre tatimpaguesve në procesin e shqyrtimit të ligjit të fshirjes.

3. Administrata tatimore apo doganore për detyrimet që fshihen/shuhen sipas këtij ligji, në rastin kur i ka filluar, ndërpret procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve. Për detyrimet tatimore ose doganore që nuk përfitojnë nga falja sipas këtij ligji, procedurat e mbledhjes së detyrimeve vijojnë të kryhen sipas përcaktimeve në legjislacionet përkatëse.

3.1 Për detyrimet tatimore që nuk përfitojnë nga falja sipas këtij ligji, procedurat e mbledhjes së detyrimeve vijojnë të kryhen sipas përcaktimeve në kreun XI “Mbledhja me forcë i detyrimit tatimor të papaguar” të ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, të ndryshuar.

3.2 Për detyrimet doganore që nuk përfitojnë nga falja sipas këtij ligji, procedurat e mbledhjes së detyrimeve vijojnë të kryhen sipas përcaktimeve në Kodin Doganor dhe dispozitave zbatuese të tij.

XII. PROCEDURA E HEQJES NGA QARKULLIMI TË MJETEVE QË NUK JANË NË PËRDORIM DHE FSHIRJES SË DETYRIMEVE TATIMORE PËR KËTO MJETE

1. Hiqen nga qarkullimi të gjitha mjetet e regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, për të cilat nuk është kryer asnjë veprim me taksat për këto mjete pas datës 31 dhjetor 2011 e në vijim.

“Veprim”, nënkuptohen datën e pagesës së taksës në DPSHTRR, pavarësisht vitit të cilit i përket, apo afatit të vlefshmërisë së tyre.

2. Heqja nga qarkullimi e këtyre mjeteve bëhet pasi fshihen/shuhet detyrimet tatimore të papaguara për to, si: taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve dhe taksën vjetore të qarkullimit rrugor, taksa vjetore e mjeteve të përdorura, taksa e mjeteve luksoze, si dhe gjobat e llogaritura për efekt të mospagimit të taksave.

Subjektet/personat përgjegjës kanë të drejtë që brenda datës 31.12.2017, të paraqiten pranë drejtorive rajonale për të kryer, pa pagesë, veprimet përkatëse të heqjes nga qarkullimi të mjetit rrugor, të dorëzojnë:

- a) dokumentit e identifikimit të personit përgjegjës;
- b) formularin e vetëdeklarimit për shkatërrimin, skrapimin e mjetit, sipas modelit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRr);
- c) certifikatën e pronësisë;
- d) lejen e qarkullimit;
- e) targat e mjetit.

Në rastet kur subjektet/personat përgjegjës, nuk disponojnë këto dokumente DRSHTRR-të, bën heqjen nga qarkullimi të mjetit rrugor, brenda datës 31.12.2017, pasi subjekti/personi përgjegjës të dorëzojë formularin e vetëdeklarimit, sipas modelit të përgatitur nga DPSHTRr-ja, për:

- a) shkatërrimin, skrapimin të mjetit;
- b) mungesën e certifikatës së pronësisë;
- c) mungesën e lejes së qarkullimit;
- d) mungesën e targave.

Shembull:

- a- Subjekti/personi përgjegjës i mjeti me targë TRxxxxA i cili ka paguar taksat për herën e fundit në DPSHTRr me datën 31.12.2011, pavarësisht vitit të cilit i përket taksat, apo afatit të vlefshmërisë së tyre, ka të drejtë të kërkojë heqjen nga qarkullimi pranë Drejtorisë Rajonale ku mjeti është i regjistruar brenda datës 31.12.2017.

DRSHTRr përkatëse pasi fshin/shuan detyrimet tatimore të papaguara për to, bën heqjen nga qarkullimi të mjetit.

- b- Subjekti/personi përgjegjës i mjeti me targë TRxxxxA ka paguar taksat për herë të fundit në DPSHTRr me datën 3.1.2012, pavarësisht vitit të cilit i përket taksat, apo afatit të vlefshmërisë së tyre dhe kërkon heqjen nga qarkullimi të mjetit pranë drejtorisë rajonale ku mjeti është i regjistruar, përfiton nga gjobat e llogaritura për efekt të mospagimit të taksave për periudhën janar 2011 deri dhjetor 2014, me kushtin që subjektet/personat përgjegjës, brenda datës 31.12.2017, të kryejnë pagesën e të gjitha detyrimeve të taksës për periudhën janar 2011 deri taksën e vitit 2017 me përjashtim të gjobave dhe kamtëvonesave për periudhën janar 2011 deri dhjetor 2014.

3. Subjektet/personat përgjegjës të cilët paraqiten me dokument identifikimi dhe kërkojnë moskryerjen e procedurës së heqjes nga qarkullimi të mjetit ose mbajtjen aktiv të tij, u fshihen detyrimet tatimore për periudhat dhjetor 2010 e më parë, me kusht që të paguajnë detyrimet për periudhën Janar 2011 e në vijim, me përjashtim të gjobave për mos pagesë të taksave të periudhës Janar 2011 deri me Dhjetor 2014 të cilat fshihen/shuhet me kushtin e pagesës së të gjitha detyrimeve.

Shembull:

Subjekti/personi përgjegjës i mjeti me targë TRxxxxA paraqitet pranë drejtorisë rajonale ku mjeti është i regjistruar për të mbajtur mjetin në qarkullim(akti) , ai përfiton nga gjobat e llogaritura për efekt të mospagimit të taksave për periudhën janar 2011 deri dhjetor 2014, me kushtin që subjekti/personi përgjegjës, brenda datës 31.12.2017, të kryej pagesën e të gjitha detyrimeve të taksës për periudhën janar 2011 deri taksën e vitit 2017 me përjashtim të gjobave dhe kamtvonesave për periudhën janar 2011 deri dhjetor 2014.

4. Gjithashtu përfitojnë nga fshirja pjesore e detyrimeve, pra fshihen gjobat e llogaritura për efekt të mospagimit të taksave të mjeteve që rezultojnë të papaguara në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji për periudhën janar 2011 deri dhjetor 2014, me kushtin që subjektet/personat përgjegjës, të paraqiten pranë DPSHTRr-së për të kryer pagesën totale të taksave të prapambetura.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me hyrjen në fuqi të ligjit, nëpërmjet strukturave të saj, harton listën e mjeteve që janë objekt i pikës 1 dhe 2, të nenit nr.12 të ligjit 33/2017, datë 30.3.2017 dhe e publikon atë në faqen zyrtare të saj në adresën www.dpshttr.gov.al.

Personat e interesuar mund të bëjnë verifikimin e targës së mjetit në këtë listë dhe subjektet/personat përgjegjës paraqiten në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor ku mjeti është i regjistruar, për të vazhduar procedurat e mëtejshme sipas këtij udhëzimi.

Subjektet/personat përgjegjës që disponojnë mjete të cilat nuk janë të përfshirë në listën e mësipërme, dhe plotësojnë kriteret e mësipërme për heqjen nga qarkullimi, paraqiten ose dërgojnë në rrugë postare të dhënat për mjetet e tyre në Drejtorinë Rajonale ku kanë mjetin e regjistruar.

6. Nëse brenda datës 31.12.2017, personat e interesuar nuk paraqiten për të kërkuar mbajtjen aktiv të mjetit, DPSHTRR-ja do të kryejë pa pagesë, heqjen nga qarkullimi të mjetit dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore të tij.

Lista e mjeteve me targat përkatëse të çregjistruara sipas këtij ligji, i dërgohet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit për bllokimin dhe sekuestrimin e tyre në rast se konstatohen në qarkullim. Strukturat e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, kryejnë procedurat e sekuestrimit.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor nëpërmjet drejtorive rajonale, merr masa për evidentimin, fshirjen/shuarjen dhe sistemimin e detyrimeve të taksave që parashikohen nga ligji nr. 33/2017, datë 30.3.2017. Procesi i dokumentimit fshirjes/ shuarjes së detyrimeve tatimore objekt i këtij ligji nga ana e DPSHTRR-së do të kryhen brenda 6 muajve pas afatit përfundimtar të zbatimit të këtij ligji.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRr), harton procedura më të detajuara për zbatimin e ligjit dhe të këtij udhëzimi.

XIII. AFATI I ZBATIMIT DHE E DREJTA E ANKIMIT

1. E drejta e subjekteve që përfitojnë nga dispozitat e këtij ligji ushtrohet deri më 31.12.2017.
2. Subjektet për të cilët fshirja e detyrimit aplikohet me kusht, nuk përfitojnë fshirje të detyrimit, nëse nuk përmbushin kushtet brenda afateve të përcaktuara në ligj.
3. Për çdo subjekt që përfiton ose jo nga fshirja e detyrimeve, organi përkatës nxjerr një akt administrativ për këtë qëllim duke njoftuar edhe subjektin.

3.1 Administrata tatimore pas përfundimit të fshirjes/shuarjes sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr.33/2017, do të njoftojë tatimpaguesit në e-Filing system me anë të një mesazhi i cili në përmbajtje të tij do të informojë se:

Në zbatim të ligjit nr. 33 datë 30/3/2017 “Për pagesën dhe fshirjen e pjesshme të detyrimeve tatimore, doganore, si dhe procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit, pas fshirjes së detyrimeve tatimore “Ju njoftojmë se efekti i tij është përfshirë në Situatën Tuaj Financiare në sistemin informatik”.

4.Për çdo subjekt që përfiton ose jo nga fshirja/shuarja e detyrimeve, organi përkatës nxjerr një akt administrativ për këtë qëllim, duke njoftuar edhe subjektin.

5. Subjektet të cilët sipas një vendimi të administratave përkatëse, nuk përfitojnë nga fshirja sipas këtij ligji, kanë të drejtë të ankohen në gjykatën administrative sipas legjislacionit të fushës në fuqi.

XIV. ORGANET ZBATUESE DHE AFATI PËR FSHIRJEN E DETYRIMEVE TATIMORE DHE DETYRIMEVE TË PAGUESHME NË DOGANË

1. Brenda datës 31.12.2017, organet përkatëse fshijnë nga regjistrat e tyre kontabël dhe nga llogaria e subjektit debitor, detyrimet që fshihen sipas këtij ligji.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi administrata tatimore, qendrore/vendore, doganore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me urdhër të brendshëm përcakton detyrat e çdo funksioni dhe njësie të deleguara për zbatimin e këtij ligji.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ngre një grup pune i cili do të monitorojë, zbatimin e ligjit dhe këtij udhëzimi, nga strukturat përkatëse në nivel qendror dhe rajonal.

5. Drejtor i Përgjithshëm i Doganave mund të përcaktojë rregulla më të detajuara për trajtimin e rasteve specifike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Arben Ahmetaj

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 99, datë 8 maj 2017.